

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

ZYRA E PERMBARIMIT PRIVAT EPSA



Nr. 505 Prot

Nr.05 Dosje



Tiranë, më 08.03.2021

URDHËR

PËR VENDOSJEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE

Drejtuar: QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

TIRANË

Unë, **Gelas YZO**, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor Privat, pranë Zyrës së Përmbarimit Privat **"EPSA" SHPK**, në referim të Urdhrit të Ekzekutimit Nr.1005 Regj. date 10.12.2020 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, kam vënë në ekzekutim këtë **Urdhër**, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr. 05 Datë 01.02.2021 kërkesën e kreditorit **Autoriteti i Konkurrencës** ndaj debitorit **Shoq. "Durrës Container Terminal" SHA**, në lidhje me titullin ekzekutiv "Vendim për gjobitje Nr.696 date 11.06.2020.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorit Njoftimin Nr.438 Prot date 23.02.2021 për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin.

KONSTATOVA Se :

Debitori është njoftuar dhe nuk i është përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të këtij lajmërimi.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi kuotat e debitorit.

Përsa më sipër, në referim të nenit 519, 527, 560, të K.Pr.Civile, dhe ligjit Nr. 26/2019 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat",

URDHEROJ :

- 1- Qendra Kombëtare e Biznesit, të kryejë veprimet për vendosjen e masës së sekuestros, **bllokimin e aksioneve me qellim moslejimin e shpërndarjes së fitimit të shoqërisë deri në shlyerjen e detyrimit në shumën 5.476.768 leke për debitorin;**
 - Shoq. “Durrës Container Terminal” SHA, NIPT L12126504E, me seli në L.4, Rr “Egnatia”, Durrës, me administrator Ada Kallçaku.
- 2- Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
- 3- Personat që bëhen pengesë, do të përgjigjen në bazë të nenit 606 të K.Pr.Civile (parag.II) që parashikon vendosjen e sanksionit të gjobës dhe kallzimin penal.

ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT “E.P.S.A” SHPK

Përmbaruesi GJYQËSOR

GELAS YZO

The image shows a handwritten signature in blue ink over a circular official stamp. The stamp contains the text 'REPUBLIKA E SHQIPERISE' at the top, 'GELAS L. YZO' in the center, and 'PËRMBARUESI GJYQËSOR PRIVAT' at the bottom. The signature is written in a cursive style and overlaps the stamp.